



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“GUIDË TURISTIKE”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-G4-IV-24

Tiranë, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
G4-07-IV-0024-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në guidë turistike.....	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
G4-07-IV-0025-24 Përgatitja e informacionit	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
G4-07-IV-0026-24 Interpretimi i informacionit	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
G4-07-IV-0027-24 Menaxhimi dhe përkujdesja e grupit.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
G4-07-IV-0028-24 Promovimi i vendit	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
G4-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
G4-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	13

G4-07-IV-0029-24 Menaxhimi i riskut	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimit	14
G4-07-IV-0030-24 Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	15
Modalitetet e vlerësimit	15
Informacion shtesë.....	16
Shënim	16

Emërtimi i kualifikimit	“Guidë turistike”			Kodi
Kohëzgjatja	3000 orë nacionale	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	K-G4-IV-24
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Guidë turistike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e organizuara nga subjekte të biznesit turistik dhe veçanërisht në agjenci turistike dhe të udhëtimit, hotele apo njësi akomoduese, autoritete qendrore dhe lokale, si dhe organizata të tjera me qëllim udhërrëfimin e grupeve të ndryshme turistike. Zhvillimi të individit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Guidë turistike” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme kualifikimin profesional “Hoteleri-turizëm” niveli II-të në KSHK, referuar nivelit II të KEK; janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Guidë turistike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës si i vetëpunësuar, si udhërrëfyes turistik i punësuar në operator turistik, pranë zyrave të informacionit, hoteleve, organizatorëve të eventeve, si dhe në bizneseve të tjera në industrinë e mikpritjes. Me përfundimin e kualifikimit profesional “Guidë turistike” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	G-II-05-14; G4-III-18			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Guidë turistike”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënës të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënës.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
8. Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
10. Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
11. Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
12. Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
13. Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
14. Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
15. Të demonstrojë aftësinë për të kontrolluar cilësinë e veprimtarive të punës;
16. Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

NJËSITË E TË NXËNËS TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënës (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

G4-07-IV-0024-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në guidë turistike

Rezultatet e të nxënës në njohuri

1. Të shpjegojë veçoritë, elementët përbërës dhe trendet kryesore të turizmit në Shqipëri;
2. Të shpjegojë llojet dhe format e turizmit;
3. Të shpjegojë tipet dhe karakteristikat e ndërmarrjeve turistike;
4. Të shpjegojë elementët përbërës të programit turistik;
5. Të shpjegojë etapat e organizimit të punës;
6. Të shpjegojë aspektet e bashkëveprimit me aktorët kryesorë në tregun turistik;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të listës së kontakteve sipas programit/itinerarit;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (kompjuter, intranet, internet, aplikacionet etj.);
9. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit, funksionin dhe përdorimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës të udhërrëfyesit turistik;
10. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës;
11. Të shpjegojë formatet dhe mënyrat e raportimit;
12. Të përshkruajë kategoritë e paketave turistike;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë etapat e organizimit të punës duke koordinuar punën me bashkëpunëtorët dhe aktorët e tjerë në tregun turistik sipas programit;
2. Të planifikojë mjetet, materialet dhe pajisjet e punës të udhërrëfyesit turistik sipas llojit të itinerarit;
3. Të përzgjedhë kategoritë e paketave turistike.

Kriteret e vlerësimit

- Kontrollon paraprakisht kalendarin e punës (agjendën);
- Shqyrton zbatueshmërinë e programit sipas itinerarit të propozuar;
- Propozon ndryshime të programit sipas nevojës, duke argumentuar arsyet objektive të ndryshimit.
- Merr në dorëzim programin dhe dokumentacionin shoqërues sipas listës së kontrollit.
- Përditëson listën e kontakteve të bashkëpunëtorëve sipas programit/itinerarit.
- Bashkërendon (koordinon) punën me bashkëpunëtorët e tjerë sipas programit/itinerarit.
- Raporton rregullisht tek operatori turistik;
- Zbaton rregullat e higjienës referuar Kodit të etikës.
- Planifikon mjetet, pajisjet dhe materialet e punës sipas llojit të programit;
- Përzgjedh mjetet e punës të udhërrëfyesit turistik sipas programit;
- Përdor mjetet dhe pajisjet punës të udhërrëfyesit turistik sipas manualit;
- Përdor Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (kompjuter, intranet, internet, aplikacione etj.), gjatë planifikimit të punës;
- Planifikon burime shtesë për menaxhimin e situatave të paparashikuara;
- Identifikon kategoritë e paketave turistike sipas llojit;
- Përshkruan karakteristikat e kategoritë të paketave turistike të llojeve të ndryshme;

- Përcakton paketën turistike të përshtatshme sipas kualifikimit të udhërrëfyesit;

G4-07-IV-0025-24 Përgatitja e informacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë tiparet e elementëve gjeografik të mjedisit fizik dhe natyror dhe karakteristikat e tyre;
2. Të shpjegojë elementët e trashëgimisë kulturore;
3. Të përshkruajë bazat e arkeologjisë në Shqipëri;
4. Të shpjegojë zhvillimet në historinë e Shqipërisë dhe ekzistencën e këndvështrimeve të aktorëve të huaj;
5. Të interpretojë elementët e hartave që përdor udhërrëfyesi turistik;
6. Të shpjegojë zhvillimet demografike në vendin tonë;
7. Të përshkruajë llojet e artit shqiptar;
8. Të përshkruajë elementët dhe karakteristikat e arkitekturës në Shqipëri;
9. Të përshkruajë zhvillimet e aktualitetit gjeopolitik, ekonomik dhe social-kulturor;
10. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së tipologjisë dhe specifikave të grupit (demografisë, interesit, pritshmërisë, etj.);
11. Të klasifikojë burimet e besueshme të informacionit;
12. Të argumentojë përzgjedhjen e metodave të grumbullimit të informacionit;
13. Të përshkruajë etapat e përgatitjes së informacionit sipas programi turistik.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përzgjedhë informacionet e përmbajtjes të programit turistik duke përdorur metodat e duhura të grumbullimit të informacionit;
2. Të zbatojë etapat e përgatitjes së informacionit sipas programi turistik.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh metodat e duhura të grumbullimit të informacionit;
- Përzgjedh informacionin e duhur sipas programit dhe tipologjisë së grupit;
- Përzgjedh informacion nga burime të ndryshme e të besueshme informacioni sipas programit dhe tipologjisë së grupit;
- Përzgjedh informacionin e duhur për mjedisin fizik dhe natyror sipas programit turistik;
- Përzgjedh informacionin e duhur për trashëgiminë kulturore sipas programit turistik;
- Përzgjedh informacionin e duhur për arkeologjinë sipas programit turistik;
- Përzgjedh informacionin e duhur për elemente të arkitekturës në Shqipëri, sipas karakteristikave të tyre;
- Përgatit informacion të plotë për mjedisin fizik dhe natyror referuar programit.
- Përgatit informacion të plotë për demografinë sipas programit;
- Përgatit informacion të plotë për historinë dhe arkeologjinë sipas programit;

- Përgatit informacion të plotë për trashëgiminë kulturore, materiale dhe shpirtërore sipas programit turistik;
- Përgatit informacion të plotë për llojet e artit shqiptar;
- Përgatit informacion të plotë për zhvillimet në historinë e Shqipërisë dhe ekzistencën e këndvështrimeve të aktorëve të huaj;
- Përgatit informacion të plotë për zhvillimet e aktualitetit gjeopolitik, ekonomik dhe social-kulturor;
- Identifikon saktë tipologjinë, specifikat dhe kërkesat e turistëve sipas demografisë, interesit, pritshmërisë, etj.;

G4-07-IV-0026-24 Interpretimi i informacionit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së teknikës së interpretimit të informacionit, sipas tipologjisë së grupit dhe programit;
2. Të shpjegojë teknikat e udhërrëfimit sipas programit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të një fjalori të pasur dhe ilustrues;
4. Të shpjegojë rëndësinë e përcjelljes së informacionit në mënyrë të balancuar në sasi dhe cilësi;
5. Të shpjegojë rëndësinë e qëndrimit neutral mbi tema si: politika, feja, sporti, gjinia etj.;
6. Të shpjegojë rëndësinë e ndërveprimit me etikë profesionale sipas tipologjisë së grupit;
7. Të shpjegojë dallimin e fakteve nga legjendat;
8. Të përshkruajë përdorimin e teknikave të orientimit në hapësirë.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë teknikat e interpretimit të informacionit dhe udhërrëfimit, sipas tipologjisë së grupit dhe programit;
2. Të përdorë teknika të orientimit në hapësirë.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton teknikat e interpretimit sipas programit;
- Zbaton teknikat e udhërrëfimit sipas programit;
- Përdor një fjalor të pasur dhe ilustrues;
- Përdor gjuhë kuptimplotë të trupit sipas rregullave të komunikimit në publik;
- Përdor intonacionin e duhur gjatë interpretimit të informacionit;
- Përcjell informacionin në mënyrë etike dhe argëtuese;
- Përcjell informacionin në mënyrë të balancuar në sasi dhe cilësi;
- Eviton paragjykimet personale mbi tema si: politika, feja, sporti, gjinia etj., gjatë udhërrëfimit;
- Siguron vazhdimisht që të gjithë po dëgjojnë;
- Jep informacion objektiv dhe subjektiv duke referuar detyrimisht burimin e informacionit;
- Dallon faktet nga legjendat referuar burimeve zyrtare të informacionit;

- Përdor saktë busullën për t'u orientuar në natyrë;
- Përdor saktë teknikat e orientimit sipas elementeve të natyrës (yjet, dielli, pemët, bimët, kafshët, etj.);
- Përdor saktë llojet e ndryshme të hartave për t'u orientuar në natyrë, sipas programit.

G4-07-IV-0027-24 Menaxhimi dhe përkujdesja e grupit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të grupit mbi doket, zakonet, traditat e destinacionit;
2. Të shpjegojë teknikat e prezantimit të vetes dhe të programit;
3. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e menaxhimit të kohës;
4. Të përshkruajë rregullat e pritjes dhe përcjelljes;
5. Të shpjegojë teknikat e menaxhimit të krizave, konflikteve dhe situatave të paparashikuara;
6. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për aspekte të sigurisë sipas llojit të destinacionit;
7. Të përshkruajë rregullat e komunikimit dhe asistencës ndaj personave me aftësi ndryshe;
8. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas kushteve klimaterike dhe llojit të destinacionit;
9. Të shpjegojë rëndësinë e informimit për shërbimet e emergjencave.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë teknikat e prezantimit të vetes dhe të programit;
2. Të menaxhojë kohën gjatë zbatimit të programit turistik;
3. Të përdorë teknikat e menaxhimit të krizave, konflikteve dhe situatave të paparashikuara;
4. Të informojë për aspekte të sigurisë sipas llojit të destinacionit;
5. Të informojë grupin mbi elementë kulturorë dhe socialë të zonës.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e pritjes së grupit;
- Zbaton rregullat e përcjelljes së grupit;
- Prezanton veten tek grupi;
- Prezanton programin, destinacionin, ndalesat, hotelin etj. tek grupi duke përdorur fjalor të kuptueshëm;
- Informon grupin për kontaktet e udhërrëfyesit, mjetin e transportit, etj.
- Kontrollon prezencën e grupit sipas listës emërore, para çdo nisje.
- Informon grupin për oraret dhe pikat e takimit;
- Menaxhon me përpikmëri kohën për të respektuar afatet e programit turistik;
- Asiston grupin gjatë kryerjes së vizitave në përmbushje të itinerarit, sipas nevojës;
- Realizon me përpikmëri programin;
- Menaxhon situata të paparashikuara sipas procedurave përkatëse;
- Merr masa për parandalimin e konflikteve duke adresuar çështjet në kohë dhe me paanësi.

- Menaxhon me qetësi/gjakftohtësi konfliktet kur linden;
- Krijon klimë miqësore në grup sipas rregullave të komunikimit;
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me grupin;
- Përdor rregullat e komunikimit dhe asistencës ndaj personave me aftësi ndryshe;
- Informon grupin për aspekte të sigurisë para dhe gjatë programit, sipas llojit të destinacionit;
- Informon grupin për kushtet atmosferike dhe vështirësitë e terrenit sipas destinacionit;
- Informon grupin për shërbimet e emergjencës;
- Informon grupin mbi zakonet krahinore sipas zonës;
- Informon grupin mbi traditat e zonës;
- Informon grupin mbi elementët social (familja, martesë etj.) të zonës.

G4-07-IV-0028-24 Promovimi i vendit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet e marketingut për turizmin;
2. Të përshkruajë teknikat e promovimit;
3. Të përshkruajë format dhe mjetet e promovimit;
4. Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të vlerave unike të vendit;
5. Të rendisë strukturat përgjegjëse për promovimin e vendit dhe funksionin e tyre;
6. Të përshkruajë rëndësinë e informimit të vizitorëve për sigurinë në vend;
7. Të shpjegojë mënyrat e ndërveprimit në ambientet publike, sociale, ekonomike, etj.;
8. Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare;
9. Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore;
10. Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të figurave të shquara shqiptare;
11. Të përshkruajë momentet historike në historinë botërore që kanë ndikuar në historinë shqiptare;
12. Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të trashëgimisë natyrore, florës dhe faunës;
13. Të përshkruajë ngjashmëritë dhe diferencat e trashëgimisë kulturore, natyrore, florës dhe faunës, me vendet e origjinës së vizitorëve. (ose duke përdorur referenca krahasimore globalisht të njohura).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e promovimit dhe parimet e marketingut për turizmin;
2. Të realizojë promovimin e vlerave të vendit;
3. Të promovojë elementët natyror dhe demografik.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor teknikat e duhura të promovimit për turizmin;
- Zbaton saktë parimet e marketingut për turizmin;
- Përdor mjete të ndryshme për promovim (kanalet e komunikimit audio, video, printime,

referencë etj.);

- Informon vizitorët për aspekte të sigurisë në vend dhe gjatë zhvillimit të itinerarit turistik;
- Informon vizitorët për dallimet (pritsmërinë) kulturore në vend;
- Promovon vlerat e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare të vendit;
- Promovon vlerat e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të vendit;
- Promovon figurat e shquara shqiptare;
- Informon vizitorët për ngjarjet historike botërore që kanë ndikuar në historinë shqiptare;
- Informon vizitorët për pozitën gjeografike dhe ndikimet gjeo-politike duke përdorur terminologji profesionale;
- Promovon mjedisin, relievin dhe klimën në vend, sipas teknikave të marketingut;
- Promovon florën dhe faunën në vend, sipas teknikave të marketingut;
- Promovon burimet natyrore të vendit, sipas teknikave të marketingut.

G4-32-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe Kodit të Punës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore;
3. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit e burimeve të nevojshme për zbatimin e detyrave;
4. Të shpjegojë rëndësinë e trajnimit të vazhduar profesional;
5. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes pjesë në panaire, seminare, workshop-e, e konferenca të ndryshme profesionale;
6. Të shpjegojë rëndësinë e ndjekjes së trajnimit për dhënien e ndihmës së parë;
7. Të shpjegojë veprimet financiare dhe dokumentet përkatëse, që lidhen me funksionin e udhërrëfyesit;
8. Të shpjegojë rëndësinë e raporteve dhe pasqyrave financiare dhe statistikore;
9. Të përshkruajë mënyrën e plotësimit dhe ruajtjes së dokumentacionit;
10. Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
11. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës, si dhe çmimit të një shërbimi.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor dhe Kodin të Punës;
2. Të kryejë planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të nevojshme;
3. Të kryejë veprime financiare;
4. Të kryejë trajnime të vazhduara bashkëkohore.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin tatimor në fuqi;

- Zbaton Kodin e Punë dhe legjislacionin në fuqi;
- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore, sipas programit turistik;
- Planifikon burimet e nevojshme financiare, sipas nevojës;
- Përzgjedh burimet njerëzore sipas kualifikimet dhe nevojave;
- Siguron burimet financiare, sipas planifikimit;
- Koordinon veprimtarinë e burimeve njerëzore, sipas nevojës;
- Planifikon burime të tjera shtesë për situata të pa parashikuara;
- Përgatit raporte, pasqyra financiare dhe statistikore, sipas formateve të caktuara dhe kërkesave;
- Plotëson dhe ruani dokumentacionin financiar sipas formateve të caktuara;
- Llogarit kostot e mjeteve, pajisjeve, materialeve, shërbimeve sipas rregullave
- Llogarit çmimin përfundimtar të një shërbimi, sipas rregullave;
- Plotëson dhe gjeneron faturat e shit-blerjes, sipas sistemit të fiskalizimit;
- Kryen vazhdimisht trajnime për zhvillimin profesional dhe të karrierës;
- Merr pjesë vazhdimisht në panaire, seminare, workshop-e, e konferenca të ndryshme profesionale.

G4-31-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të kodit e etikës në turizëm;
2. Të shpjegojë parimet e etikës profesionale;
3. Të shpjegojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
4. Të shpjegojë parimet e punës në grup;
5. Të shpjegojë rëndësinë e kodit të veshjes sipas programit, situatave dhe mjedisit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të gjuhës së trupit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një bashkëbisedim;
8. Të evidentojë llojet dhe veçoritë e komunikimit me turistët;
9. Të dallojë në mënyrë të përgjithshme kulturat e popujve të ndryshëm;
10. Të shpjegojë veçoritë e psikologjisë të turistit dhe grupit turistik;
11. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknikave të komunikimit profesional;
12. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në një gjuhë të huaj;
13. Të dallojë terminologjinë teknike ndërkombëtare të udhërrëfyesit;
14. Të shpjegojë teknikat e animimit dhe përdorimet e tyre;
15. Të shpjegojë rëndësinë e zotërimit të një fjalori të pasur gjuhësor;
16. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë kodin e etikës së udhërrëfyesit;
2. Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;

3. Të zbatojë parimet e punës në grup.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton parimet e etikës profesionale, sipas rregullave;
- Siguron privatësinë e të dhënave sipas legjislacionit përkatës;
- Ruan integritetin e të dhënave sipas politikave të sigurisë;
- Zbaton rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët.
- Zbaton kodin e veshjes sipas programit, situatave dhe mjedisit;
- Përdor me korrektësi, gjuhën e trupit në përputhje me situatën;
- Dëgjon në mënyre aktive dhe të vëmendshme gjatë një bashkëbisedimi;
- Përzgjedh mënyrën e komunikimit sipas veçorive të turistëve dhe grupit turistik;
- Përdor rregullisht teknika të komunikimit profesional;
- Përdor rregullisht terminologjinë teknike ndërkombëtare të udhërrëfyesit;
- Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, fetare dhe të tjera;
- Komunikon duke respektuar kulturat e popujve të ndryshëm;
- Përdor një fjalor të pasur gjuhësor gjatë komunikimit me vizitorët;
- Komunikon në një gjuhë të huaj;
- Përdor teknikat e animimit (lojëra, gjëgjëza, pyetësor, rrëfim personal etj.)
- Zbaton teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të shpejtë me të tjerët duke u përshtatur me to.
- Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Zbaton saktë parimet e ndërveprimit në grup;
- Jep dhe merrni udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës.

G4-07-IV-0029-24 Menaxhimi i riskut

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për sigurinë në turizëm dhe legjislacionit shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen e sigurisë gjatë lëvizjes;
3. Të nënvizojë rregullat e qarkullimit rrugor për këmbësorë dhe mjetet e transportit;
4. Të theksojë rregullat e sigurisë në ndërtesë;
5. Të përshkruajë llojet e rreziqeve në terren dhe masat për parandalimin e tyre;
6. Të përshkruajë rregullat për mbrojtjen dhe sigurinë e vizitorëve në turizmin e aventurës;
7. Të përshkruajë llojet e emergjencave dhe protokollet përkatëse të tyre;
8. Të përshkruajë përdorimin e manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
9. Të shpjegojë mënyrat dhe mjetet e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
10. Të shpjegojë kuptimin e sinjalistikave në mjedisin e punës;

11. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
12. Të japë shembuj për përdorimin e pajisjeve të MZSH³;
13. Të përshkruajë protokollet në raste pandemie;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurisë gjatë realizimit të programit turistik;
2. Të zbatojë legjislacionin në fuqi për rregullat e sigurimit teknik.

Kriteret e vlerësimit

- Vlerëson rreziqet dhe kërcënimet përpara realizimit të udhëtimit referuar programit;
- Shmang në kohë reale rreziqet gjatë realizimit të udhëtimit;
- Zbaton procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë në raste emergjence;
- Zbaton rregullat për mbrojtjen dhe sigurinë e vizitorëve në turizmin e aventurës;
- Zbaton rregullat e qarkullimit rrugor për këmbësorët dhe mjetet e transportit;
- Informon për procedurat standarde të sigurisë në ndërtesa gjatë turit sipas sinjalistikës;
- Informon për procedurat standarde të sigurisë në automjete sipas sinjalistikës përkatëse;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Raporton në kohë reale për incidentet e ndodhura;
- Zbaton manualet përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e ndërtesës sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës;
- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse.
- Përdor pajisjet e MZSH, sipas manualeve;
- Kontrollon zbatimin e rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- Raporton sipas rastit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë teknike.
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

G4-07-IV-0030-24 Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për një mjedis dhe zhvillim të qëndrueshëm;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për zonat e mbrojtura;
3. Të përshkruajë elementet dhe karakteristikat e mjedisit;
4. Të përshkruajë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
5. Të shpjegojë rolin e njeriut në mbrojtjen e mjedisit gjatë ushtrimit të veprimtarive turistike;

³ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

6. Të shpjegojë pasojat e veprimtarisë njerëzore në natyrë gjatë ushtrimit të veprimtarive turistike;
7. Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit, florës dhe faunës;
8. Të përshkruajë rreziqet e ndotjes dhe masat parandaluese të tyre;
9. Të përshkruajë rregullat për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe për depozitimin e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin në fuqi për një mjedis dhe zhvillim të qëndrueshëm;
2. Të mbrojë mjedisin gjatë realizimit të programit turistik.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura;
- Zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm për strukturat akomoduese, mjetet e transportit etj.
- Përshkruan rëndësinë e marrjes pjesë në forume dhe grupe pune lidhur me qëndrueshmërinë;
- Përdor në mënyrë racionale burimet dhe materialet;
- Mbron mjedisin gjatë ushtrimit të veprimtarive turistike, sipas legjislacionit;
- Mbron biodiversitetin, florën dhe faunën, sipas legjislacionit;
- Merr masa për të shmangur rreziqet nga ndotja, sipas legjislacionit;
- Jep shembullin personal për mbrojtjen e mjedisit;
- Ruan dhe depozitoni mbetjet në vendet e caktuara, sipas protokolleve.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në guidë turistike	10	G4-07-IV-0024-24
2	Përgatitja e informacionit	15	G4-07-IV-0025-24
3	Interpretimi i informacionit	15	G4-07-IV-0026-24
4	Menaxhimi dhe përkujdesja e grupit	15	G4-07-IV-0027-24
5	Promovimi i vendit	10	G4-07-IV-0028-24
6	Sipërmarrje dhe edukim karriere	10	G4-32-IV-0005-24
7	Komunikimi dhe etika profesionale	15	G4-31-IV-0006-24
8	Menaxhimi i riskut	5	G4-07-IV-0029-24
9	Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm	5	G4-07-IV-0030-24
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

Shënim

Shpjegime të kodit të kualifikimit: K-G4-IV-24

K - Kualifikim

G - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

4 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

IV - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: G4-07-IV-0024-24

G4 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

07 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njesisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0024 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit